11600	Kontributi i punëtorit		85,820.80	85,820.80	786.68
11700	Kontributi i punëdhënsit		85,820.80	85,820.80	786.68
11115	Pagesa për sindikat		7,514.85	7,514.85	-45.96
11125	OIK		515.93	515.93	-12.84
11126	OMK		1,920.00	1,920.00	1,786.24
11400	punëtorët me kontrat - jo në liste të pagave			0.00	-1,686.29
	Totali i pagave	0.00	1,802,221.74	1,802,221.74	14,790.50
13130	Shpenzimet e udhëtimit mbrenda vendit	3,747.08	3,346.00	7,093.08	4,949.24
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashte vendit	733.48	1,098.80	1,098.80	365.32
13141	Medijet e udhëtimit zyrtar jashte vendit	1,151.88	299.00	594.67	-557.21
13142	Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar jashte vendit	140.32		0.00	-140.32
13143	shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar jashte vendit	1,000.69		0.00	-1,000.69
13210	Shpenzimet e rrymes	57,156.26	10,437.02	39,006.10	-7,713.14
13220	Shpenzimet ujit	4,573.92	371.50	12,122.93	7,920.51
13230	Shpenzimet e mbeturinave	5,439.01	333.57	10,032.56	4,927.12
13250	Shpenzimet e telefonise fikse	1,417.24	329.05	3,256.80	2,168.61
13310	Shpenzimet per internet	1,260.00	350.21	350.21	-909.79
13320	Shpenzimet e telefonis mobile	8,812.54	3,621.51	3,621.51	-5,191.03
13330	Shpenzimet postare	48.20	16.90	16.90	-31.30
13420	Sherbimet e perfaqesimit dhe avokatures	5,800.00		0.00	-5,800.00
13430	Sherbime te ndryshme shendetesore	10,000.00		12,176.28	2,176.28
13450	sherbime shitype - jo marketing	0.00	895.00	4,949.00	5,844.00
13460	Sherbime kontraktuese tjera	24,794.38	13,435.80	5,509.01	-18,944.81
13470	Sherbime teknike	1,100.00	320.00	320.00	-460.00
13480	Shpenzimet per anetaresim	0.00	395.00	395.00	395.00
13501	Mobilje	10,756.00	422.00	422.00	-10,334.00
13503	Kompjuter	1,600.00		3,910.00	2,310.00
13505	Makina fotokopjuese	0.00		1,050.00	1,050.00
13509	Pajisje tjera	8,464.95	899.80	13,547.70	5,982.55
13610	Furnizime per zyre	9,214.38	399.00	8,686.70	-128.68
13611	Furnizime me dokumenta blanko	1,918.00		9,085.70	-1,918.00
13620	Furnizim me ushqim dhe piqe	4,579.20	5,232.30	2,027.70	-2,680.80

13630	Furnizime mjeksore	10,198.15	4,392.50	4,392.50		4,392.50	-5,805.65
13640	Furnizime pastrimi	331.00	490.30	490.30		490.30	159.30
13650	Furnizim me veshmbathje	885.00	500.00	500.00	750.00	1,250.00	365.00
13720	Naftë per ngrohje qendrore	4,420.00	430.95	430.95		430.95	-3,989.05
13760	Furnizim me lende djegese (Dru)	27,518.00	17,839.99	17,839.99		17,839.99	-9,678.01
13770	Derivate per xhenerator	802.56	272.13	272.13		272.13	-530.43
13780	Derivate per vetura	8,023.20	5,079.73	5,079.73		5,079.73	-2,943.47
13950	Regjistrim i automjeteve	1,000.00			970.00	970.00	-30.00
13951	Sigurimi i automjeteve	490.88			1,426.09	1,426.09	935.21
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	4,211.00	5,312.00	5,312.00	2,930.00	8,242.00	4,031.00
14020	Mirembajtja e ndertesave	18,281.40	9,086.97	9,086.97	18,734.45	27,821.42	9,540.02
14023	Mirembajtja e shkollave	1,389.00			1,520.00	1,520.00	131.00
14032	Mirëmbajtja e autorrugëve lokale	36,694.28	6,679.62	6,679.62	19,448.93	26,128.55	-10,565.73
14040	Mirembajtja e teknologjise informative	1,383.25	1,231.00	1,231.00	1,998.00	3,229.00	1,845.75
14050	Mirembajtja e mobiljeve dhe paisjeve	809.00	105.00	105.00		105.00	-704.00
14210	Reklammat dhe konkurset	941.00	400.00	400.00	100.00	500.00	-441.00
14220	Botimet e publikimet	462.00	1,480.00	1,480.00	1,620.00	3,100.00	2,638.00
14310	Dreka zyrtare	5,581.48	1,238.73	1,238.73	5,969.50	7,208.23	1,626.75
14320	Drekat zyrtare jashte vendit	146.02				0.00	-146.02
13260	shpenzime - vendime gjyqesore	0.00	3,256.75	3,256.75		3,256.75	3,256.75
14410	shpenzime - vendime gjyqesore	1,821.68	17,596.73	17,596.73		17,596.73	15,775.05
	Totali për shërbime mallra dhe komunali	287,493.19	116,475.14	116,475.14	177,224.22	293,699.36	6,206.17
22200	Subvencione dhe transfera	30,970.00	1,250.00	1,250.00	9,190.00	10,440.00	-20,530.00
	Totali i subvencioneve	30,970.00	1,250.00	1,250.00	9,190.00	10,440.00	-20,530.00
31000	Investime Kapitale	90,586.73	24,608.98	24,608.98	94,516.12	119,125.10	28,538.37
	Totali i investimeve kapitale	90,586.73	24,608.98	24,608.98	94,516.12	119,125.10	28,538.37
	Gjithsej shpenzimet	2,196,481.16	142,334.12	142,334.12	2,083,152.08	2,225,486.20	29,005.04

Komente:

Shpenzimet në vitin 2019 ne total janë 2,225,486,20€, qe nga kjo shum 142,334,12€ jane paguar obligimet e vitit 2018 dhe 2.083,152,08€ jane Shpenzime te vitit 2019, Ndersa Shpenzimet në vitin 2018 kane qene 2.196.481,16€

Shpenzimet në vitin 2019 janë më të larta në total për 29.005,04€ në krahasim me të njejten periudh të vitit 2018

Në shpenzime janë përfshi pagat dhe medijet, shërbime mallra dhe shpenzimet komunale, subvencione dhe transfera dhe investime kapitale

Shpenzimet për Paga dhe medijet të vitit 2019 janë më të larta për 14,790,50€ në krahasim me vitin 2018


Shpenzimet për shërbime mallra dhe komunali të vitit 2019 janë më të larta për 6.206,17€ në krahasim me shpenzimet e vitit 2018

Shpenzimet për subvencione dhe transfera të vitit 2019 janë më të ulta për 20.530,00€ në krahasim me shpenzimet e vitit 2018

Shpenzimet për Investime kapitale të vitit 2019 janë më të larta për 28,538,37€ në krahasim me shpenzimet e vitit 2018.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 shkronja h) Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 50 shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen “qytetarë nderi” i Komunës së Vitisë, ish Presidentin e Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani

Neni I

Me këtë propozim vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon të shpallet qytetar nderi i komunës së Vitisë ish Presidentin e Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani.

Neni II

Titulli qytetar nderi i Komunës së Vitisë z.Bujar Nishani do të ndahet me një seance solemne e cila do të mbahet me rastin e vizitës së z.Bujar Nishani që do të bëjë Komunës së Vitisë.

Neni III

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni IV

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues: Kryetari i Komunës, Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 pika 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndër-komunal dhe neni 5 pila 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder-komunal, neni 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë

NISMË

E KRYETARIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR NXITJEN E BASHKËPUNIMIT NDER KOMUNAL ME KOMUNËN E KLLOKOTIT NË FUSHËN E INFRASTRUKTURES RRUGORE

1. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me Komunën Kllokotit.
2. **Qëllimi i bashkëpunimit**- bashkëpunimi do të bëhet në fushën e infrastrukturës rrugore në realizimin e projektit me interes të përbashkët në ndërtimin e trotuareve Viti-Kllokot, Kllokot-Pozharan, dhe Viti-Mogillë.
3. Bashkangjitur me nismën do të paraqesim mendimin me shkrim dhe të arsyetuar dhe vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendi i Komunës me të cilin vendim për miratim të nismës do të njoftohen kryetarët e komunave me të cilët tentojmë të kemi bashkëpunim ndër-komunal.
4. **Arsyetim** Komuna e Vitisë dhe Komuna e Kllokotit kanë shprehë paraprakisht vullnetin e tyre për bashkëpunim dhe janë pajtuar që përmes zyrave të projekteve përkatëse të komunave të bashkëpunojnë në sferën e infrastrukturës rrugore në realizimin e projektit me interes të përbashkët në infrastrukturë rrugore që do të lidh dy komunat mes veti. Ndërtimi i trotuareve do të lidhë fshatrat e kësaj treve dhe lehtëson që popullata lokale e kësaj treve të komunikojnë me lehtë me qendrat komunale Viti dhe Kllokot.

Propozues:

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA			
Nr. i organit Org. broj		11-04-2019	
Org. brendshëm		Vlera	
02-038/02-370		Vendim	



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 pika 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim nder-komunal dhe nenit 5 pila 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder-komunal, nenit 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë

PROPOZIM VENDIM PËR NISMËN

E KRYETARIT TË KOMUNES SË VITISË PËR BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL ME KOMUNËN E KLLOKOTIT NË FUSHËN E INFRASTRUKTURES RRUGORE

Neni I

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal të Vitisë të miraton nismën për bashkëpunimin nder-komunal me Komunën e Kllokotit e infrastrukturës rrugore në realizimin e projektit me interes të përbashkët në ndërtimin e trotuareve Viti-Kllokot, Kllokot-Pozharan, dhe Viti-Mogillë.

Neni II

Bashkëpunimi nder-komunal do të zhvillohet me komunën e Kllokotit.

Neni III

Detajet e bashkëpunimit do të përcaktohen me marrëveshje të bashkëpunimit.

Neni IV

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues: Kryetari i Komunës, Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

11-04-2019

02-035/02-369

Titulli	Adresa	Drejtimi	Vlera



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 pika 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim nder-komunal dhe neni 5 pila 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder-komunal, neni 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë

**PROPOZIM VENDIM PËR AUTORIZIMIN
E KRYETARIT TË KOMUNES SË VITISË PËR BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL ME KOMUNËN E
KLLOKOTIT NË FUSHËN E INFRASTRUKTURES RRUGORE**

Neni I

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal të Vitisë të miraton propozim vendimin për **AUTORIZIMIN** e Kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunën e Kllokotit për bashkëpunimin nder-komunal me Komunën e Kllokotit në infrastrukturës rrugore në realizimin e projektit me interes të përbashkët në ndërtimin e trotuareve Viti-Kllokot, Kllokot-Pozharan, dhe Viti-Mogillë.

Neni II

Pas marrjes së autorizimit Kryetari i Komunës së Vitisë e njofton Kryetarin e Komunës së Kllokotit për nismën me të cilin kërkohet themelimin i bashkëpunimit nder-komunal.

Neni III

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues:

Kryetari i Komunës, Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 shkronja h) Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 50 shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për ndryshim plotësim të vendimit nr.01-410/03-129, të datës 28.02.2018, të Komitetit për Planifikim, Rregullim të hapësirave dhe mbrojtje të mjedisit

Neni 1.

Me këtë propozim vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që të bënë ndryshim plotësimin e vendimit nr.01-410/03-129, të datës 28.02.2018, të Komitetit për Planifikim, Rregullim të hapësirave dhe mbrojtje të mjedisit

Neni 2.

Konform nenit 1 të këtij propozim vendimi, Komitetit për Planifikim, Rregullim të hapësirave dhe mbrojtje të mjedisit duhet të ndryshohet dhe të plotësohet, ku nenin 2 i vendimit nr.01-410/03-129, të datës 28.02.2018 anëtarin me numër rendor 1. znj. Rufadije Rexhepi zëvendësohet me _____.

Neni 3.

Te gjitha pjesë tjera të vendimi nr.01-410/03-129, të datës 28.02.2018, Komitetit për Planifikim, Rregullim të hapësirave dhe mbrojtje të mjedisit mbeten në fuqi.

Neni 4.

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

Propozues:

Kryetari i Komunës: Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/1008), dispozitave të nenit 7 të Ligjit Nr.04/L - 076 për Policinë, dispozitave të nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012, MPB-së, 03/2012 të MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe nenit 50 paragrafi 50.1 pika l) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të bëhet ndryshim plotësimi i Vendimit Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë.

Neni 2

Konform nenit 1 të këtij propozim vendimi, Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë, anëtari me numër rendor 2. z. Agim Lipovica ish Komandant i Stacionit Policor në Viti zëvendësohet me z. Afrim Halili Komandant i Stacionit Policor në Viti.

Neni 3

Te gjitha pjesë tjera të vendimi Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë mbesin të pa ndryshuara.

Neni 4

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues:

Kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

11.04.2019

02-035/02 - 366



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 13 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Transparencën në Komuna, neni 7 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, neni 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen në diskutim publik për propozimin rregullor mbi themelimin dhe strukturimi e asamblesë komunale të fëmijëve

Neni 1

Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të shpallë në diskutim publik propozim rregullor mbi themelimin dhe strukturimi e asamblesë komunale të fëmijëve.

Neni 2

Propozimi në diskutim publik i propozim rregullores mbi themelimin dhe strukturimi e asamblesë komunale të fëmijëve fëmijë do të jepet në diskutim publik deri me: 30.05.2019.

Neni 3

Debati publik do të mbahet me datën: 03.06.2019 në ora 13:00 në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive për propozimet rregullor mbi themelimin dhe strukturimi e asamblesë komunale të fëmijëve.

Neni 6

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues:

Kryetari i Komunës, Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

**PROPOZIM RREGULLORE MBI THEMELIMIN DHE STRUKTURIMIN
E ASAMBLESEË KOMUNALE TË FËMIJËVE**

Viti, Prill 2019

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1, pika h të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenit 50 paragrafi 1 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM RREGULLORE MBI THEMELIMIN DHE STRUKTURIMIN E ASAMBLESË KOMUNALE TË FËMIJËVE

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Qëllimi i Rregullore

Përmes kësaj Rregullore parashihet që nga të gjitha Shkollat e Mesme të Ulëta, në tekstin e mëtejshëm SHMU, të dërgohen përfaqësuesit e zgjedhur për Asamblesën Komunale të Fëmijëve.

1.1 Plani vjetor i punës hartohet nga Asambleja Komunale e Fëmijëve, në tekstin e mëtejshëm Asambleja.

Neni 2

Qëllimet e Asamblesë Komunale të Fëmijëve

2.1 Pjesëmarrja aktive në zhvillimin dhe realizimin e veprimeve në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, sportit, punës humane dhe aktiviteteve të tjera me interes për fëmijët dhe komunitetin.

2.2 Zhvillimi i bashkëpunimit me Këshillat Drejtues të Shkollave, Këshillat e Prindërve, Këshillat e nxënësve dhe komunitetin lokal.

2.3 Krijimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit me mekanizmat dhe organizatat tjera.

2.4 Ngritja e vetëdijes për të drejtat e fëmijës, përgjegjësitë dhe gjithë përfshirja e interesave të fëmijëve/nxënësve.

2.5 Avokim mbi çështje të ngritura nga vet fëmijët

2.6 Organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete të identifikuara nga vet fëmijët dhe ato që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve

2.7 Inkurajimi i tolerancës, solidaritetit dhe demokratizimi.

2.8 Promovimi i vlerave shoqërore.

Neni 3

Kompetencat

Obligimet dhe detyrat e Asamblesë

3.1 Dhënie e kërkesave, mendimeve dhe sugjerimeve për institucionet relevante Komunale, për Këshillat e Shkollës, Këshillat e Prindërve si dhe Drejtoritë lidhur me zbatimin e rregulloreve të sjelljes në shkollë, planin e zhvillimit të shkollës, aktivitetet e lira, pjesëmarrjen në sported he konkurse të tjera dhe organizimin e të gjitha manifestimeve të nxënësve në shkollë dhe jashtë saj në interes të fëmijëve.

3.2 Të siguroj bashkëpunimin e nxënësve, edukatorëve dhe bashkëpunorëve profesional.

3.3 Informimin e nxënësve rreth çështjeve me rëndësi të veçantë për arsimimin e tyre përmes komunikimit të rregullt me këshillat e shkollave.

Neni 4 **Organizimi i Asamblesë**

- 4.1 Sektori për të Drejtat e Njeriut e ndihmon, monitoron dhe raporton për punën e Asamblesë.
- 4.2 Asambleja Komunale e Fëmijëve do të përbëhet nga 27 anëtarë, i njëjtë me numrin e anëtarve të Kuvendit Komunal.
- 4.3 Organet e Asamblesë janë: Kryetari-ja, kryesia e përbërë nga 5 anëtarë, dhe komisione të propozuara dhe të përzgjedhura nga vet asambleistët.
- 4.4 Përgjegjësi i Sektorit për të Drejtat e Njeriut në nivel komunal, organizon zgjedhjet për Asamblenë e Fëmijëve në koordinim me Drejtorinë Komunale të Arsimit.
- 4.5 Përfaqësimi i nxënësve në Asamble bëhet nga një përfaqësues në çdo shkollë proporcionalisht me numrin e nxënësve në secilën shkollë.
- 4.6 Përfaqësuesit e deleguar në Asamble, zgjedhen në SHMU përmes procesit zgjedhor dhe përfshinë nxënësit e klasave gjashtë – tetë (6- 8).
- 4.8 Përbërja e anëtarve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve, duhet të ketë reflektim gjinor.

Neni 5 **Vendimet e Asamblesë**

Asambleja merr vendime për arritjen e qëllimeve të përcaktuara dhe miraton:

- 5.1 Planin vjetor të punës së Asamblesë
- 5.2 Zgjedh dhe shkarkon kryetarin e Asamblesë
- 5.3 Shqyrton dhe miraton së paku një raport të kryesisë dhe komisioneve
- 5.4 Shqyrton dhe miraton propozimet e anëtarve të Asamblesë dhe komisioneve

Neni 6 **Mwnyra e pwrzgjedhjes sw anwtarwve pwr Asamble**

- 6.1 Në takim të përbashkët Këshilli i nxënësve fton kryesinë e klasave nga 6 – 8
- 6.2 Nga të gjithë nxënësit e ftuar në takim përzgjedhen përfaqësuesit për asamblenë në mënyrë të fshehtë, sipas Nenit 4.5, të kësaj Rregulloreje
- 6.3 Secili nxënës prezent në takim ka të drejtë të propozojë dhe të jetë i propozuar
- 6.4 Secili nxënës ka të drejtë të deklarohet se a pajtohet të jetë kandidat përfaqësues i shkollës për Asamble
- 6.5 Nxënësit e kandiduar për përfaqësues të Asamblesë, paraqiten me një fjalë rasti
- 6.6 Përzgjedhja e kandidatëve bëhet përmes procesit të votimit të hapur ose të mbyllur
- 6.7 Përzgjedhja e Asambleistëve bëhet çdo dy vite
- 6.8 Duke respektuar kuotën gjinore dhe gjithëpërfshirjen, përzgjedhen kandidatët të cilët kanë numrin më të madh të votave
- 6.9 Nëse ka numër të barabartë të votave, atëher shkohet në raundin tjetër
- 6.10 Komisioni zgjedhor është gjithëpërfshirës

Neni 7

Mbledhjet e Asamblesë

- 7.1 Katër mbledhje të Asamblesë janë obligative gjatë një viti kalendarik, ndërsa është e nevojshme edhe më shpesh me propozim të Kryetarit, Kryesisë si dhe me iniciativën e një të tretës së anëtarëve
- 7.2 Asambleja vendos me shumicën e votave të anëtarve present
- 7.3 Anëtarët informohen përmes postës elektronike dhe formave tjera për pikat e rendit të ditës, kushtet e seancës si dhe informata shtesë
- 7.4 Kuorumi për mbajtjen e mbledhjeve është gjysma plus një (shumica e thjeshtë)

Neni 8

Përgjegjësitë e anëtarve të Asamblesë

- 8.1 Anëtarët e Asamblesë kanë mandate dy vjeçar dhe mund të rizgjidhen në të njëjtin funksion
- 8.2 Mandati i anëtarve të Asamblesë përfundon me dorëheqje, pas përfundimit të mandatit ose mungesës pa arsye në tri seance radhazi
- 8.3 Asambleja raporton me shkrim tek Përgjegjësi i Sektorit për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Vitisë
- 8.4 Secili anëtarë i Asamblesë njofton Këshillin e nxënësve në shkollën e vet për punën e Asamblesë

Neni 9

Të drejtat e anëtarëve të Asamblesë

Një anëtarë i Asamblesë ka të drejtë:

- 9.1 Të marrë pjesë në arritjen e objektivave të Asamblesë
- 9.2 Të marrë pjesë në punën e Asamblesë në kushte të barabarta me anëtarët e tjerë
- 9.3 Të propozon projektet, veprimet dhe dokumentet e tjera të Asamblesë për vendimmarrje
- 9.4 Të marr pjesë në realizimin e të gjitha aktiviteteve të Asamblesë
- 9.5 Të informohet në kohën e duhur për punën dhe aktivitetet e Asamblesë
- 9.6 Të shprehet lirshëm
- 9.7 Të kërkojë dhe të marrë informata nga Kryesia për çështje të rëndësishme në lidhje me ushtrimin e funksionit të asambleistit të ri
- 9.8 Të ketë vetëm një propozim për një çështje të caktuar
- 9.9 Të shfrytëzojë ambientet e Asamblesë që u janë dhënë në dispozicion për punë dhe takime në bashkëpunim me Komunën dhe Kuvendin Komunal

Neni 10

Detyrat e anëtarëve të Asamblesë

Anëtarët e Asamblesë janë të detyruar të:

- 10.1 Të koontribuojnë në mënyrë aktive në arritjen e objektivave
- 10.2 Marrin pjesë në përputhje me interes e zgjedhësve në aktivitetet e Asamblesë
- 10.3 Ta respektojnë mendimin e njëri tjetrit
- 10.4 Kryejnë detyra tjera që I janë besuar atij/asaj nga Asambleja
- 10.5 T'i përgjigjet ftesës së Kryetarit/es së Asamblesë lidhur me Asamblenë

- 10.6 Të nënshkruhen në fillim dhe mbarim të seancës për praninë e tyre
- 10.7 Me shumicë votash të aprovonjë, ndryshojnë apo plotësojnë rendin e ditës të propozuar nga Kryetari i Asamblesë
- 10.8 Të votojnë me shumicë votash propozimin e arsyetuar për shtyrjen apo tërheqjen e pikave të caktuara në rendin e ditës

Neni 11

Mënyra e votimit

- 11.1 Votimet mund të bëhen me vota të hapura ose të mbyllura. Këtë e vendosin asambleistët;
- a) Votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës, ndërsa
- b) Votimi i mbyllët (i fshehtë) bëhet me fletëvotime. Votimin e fshehtë e udhëheqë dhe monitoron Komisioni i votimit
- 11.2 Para se të fillohet me votim të fshehtë, Asambleja propozon dhe zgjedhë tre (3) anëtarë të Komisionit për numërimin e votave dhe për gjetjen e parregullsive në votime
- 11.3 Konsiderohet I pavlefshëm fletëvotimi prej të cilit nuk mund të konstatohet me saktësi se si ka votuar asambleisti
- 11.4 Pjesëmarrësit në votim, kanë vetëm një (1) herë të drejtë të votojnë
- 11.5 Seancat janë të hapura dhe publike

Neni 12

Zgjedhja e Kryetarit/es dhe Kryesisë së Asamblesë

- 12.1 Asambleja zgjedh një (1) Kryetarë, dy (2) Nënkyetarë, një (1) Sekretarë, një (1) Arkatarë
- 12.2 Të dy Nënkyetarët propozohen dhe zgjedhen nga anëtarët e asamblesë duke votuar
- 12.3 Sekretari dhe Arkatari propozohen nga anëtarët e asamblesë dhe votohen nga Asambleja
- 12.4 Zgjedhja e Kryetarit/es bëhet me vota të hapura ose të mbyllura (shih Nenin 11)
- 12.5 Kryetari/ja i/e sapo zgjedhur pas fjalimit të tij/saj rreth objektivave përgjatë punës menjëherë hapë votimin për përzgjedhjen e Kryesisë (Nënkyetarëve, sekretarit/es, arkëtarit/es)

Neni 13

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit/es së asamblesë

- 13.1 Kryetari/ja ka mandate të plotë 2 vjeçar nga moment I zgjedhjes së tij/saj
- 13.2 Kryetari/ja mund të bëjë propozime dhe ka të drejtë vote, dhe në rast të votimit të barabartë, vota e kryetarit/es është një votë më shumë
- 13.3 Kryetari/ja ka të drejtë të ndërpresë seancën nëse ka parregullsi
- 13.4 Ka të drejtë ta largojë asamblestin/en nga salla nëse ka shkelur Kodin e Mirësjelljes
- 13.5 Kryetari/ja duhet ta thërret mbledhjen së paku katër (4) herë në vit apo sipas nevojës
- 13.6 Kryetari/ja nuk duhet të mungojë në tri (3) mbledhje radhazi, po qe se ai/ajo mungon pa arsye, atëherë mund të kërkohet shkarkimi i tij/saj
- 13.7 Kryetari/ja nuk guxon të bëjë anime (ndarje)
- 13.8 Nëse Kryetari/ja mungon, vazhdon séance me Nënkyetarin/en e parë
- 13.9 Nëse mungon edhe Nënkyetari/ja i/e parë, atëherë vazhdon me të dytin
- 13.10 Nëse Kryetari/ja bën shkelje të Rregullores dhe Kodit të Mirësjelljes, ai/ajo mund të shkarkohet me votimin e 2/3 të asambleistëve

Neni 14

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nënkryetarëve

- 14.1 Asambleja duhet të ketë dy Nënkyetarë
- 14.1 Nënkyetari/ja i/e dytë duhet të përzgjidhet nga komunitetet joshumicë (nëse ekzistojnë)
- 14.3 Nënkyetari/ja i/e Asamblesë i ndihmon Kryetarit/es në kryerjen e punëve dhe kryen punë të tjera nga fushëveprimet e tij/saj
- 14.4 Me autorizimin e Kryetarit/es, mund ta zavendësoj atë brenda dhe jashtë vendit, varësisht nga agjenda e takimit

Neni 15

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarit/es

- 15.1 Sekretari/ja i/e Asamblesë bën pjesë në Kryesi dhe ka detyrat e përshkruara
- 15.2 Sekretari/ja me kërkesë të Kryetarit thirr seancën, cakton datën, orën dhe vendin e mbajtjes së seancës dhe mban procesverbalin
- 15.3 Ruan dokumentet e Asamblesë dhe e bën evidentimin e prezencës së asambleistëve
- 15.4 Sekretari/ja ka përgjegjësi të monitorojë implementimin e planit të veprimit të Asamblesë

Neni 16

Detyrat dhe të drejtat e Kryesisë së Asamblesë

- 16.1 Kryesia e Asamblesë zgjedhet nga vet asambleistët dhe duhet të jetë e përbërë nga pesë (5) anëtarë
- 16.2 Anëtari/ja i/e Kryesisë nuk mund të ketë më shumë se një post
- 16.3 Mbajnë shënime dhe shfaqin idetë e tyre për të mirën e fëmijëve
- 16.4 Cakton rendin e ditës në bashkëpunim me anëtarët e Kryesisë, (nënkryetarët, sekretari/ja, arkëtari/ja në krye me Kryetarin/en)
- 16.5 Harton planprogramin dhe kalendarin e punës
- 16.6 Vendimet e kryesisë miratohen nga Asambleja

Neni 17

Komisionet

- 17.1 Komisionet janë organe të përkohëshme ose të përhershme që kujdesen për zbatimin e objektivave të Asamblesë
- 17.2 Komisionet që janë organe pune të përhershme:
 - a) Komisioni për bashkëpunim me organet profesionale të shkollës, këshillin e shkollës, këshillin e prindërve, mësuesit dhe komunitetin local
 - b) Komisioni për sport dhe kulturë
 - c) Komisioni për veprim humanitar
 - d) Komisioni për informim
 - e) Sipas specifikacioneve të Komunës
- 17.3 Vendimi mbi themelimin, përgjegjësitë, shuarjen e komisioneve miratohet nga Asambleja në interesin më të mirë të fëmijëve

17.4 Çdo komision ka udhëheqësinë e vet, i/e cili/a zgjedhet me votim Brenda komisionit (shih Rregulloren)

Neni 18 **Komisionet dhe detyrat e tyre**

18.1 Komisionet i kryejnë të gjitha punët dhe detyrat sipas planit të veprimit

18.2 Plani i Veprimit i çdo komisioni duhet të aprovet nga Asambleja

18.3 Komisionet mbajnë mbledhjen e përgjithshme me kryesinë

18.4 Shkarkimi i komisioneve bëhet nëse nuk respektojnë dhe nuk mbajnë përgjegjësi për punën e tyre

Neni 19 **Procesverbali**

19.1 Për punën e seancës së Asamblesë Komunale të Fëmijëve mbahet procesverbali (shih nenin 15)

19.2 Procesverbali i përmban të dhënat kryesore për punimet e seancës, propozimet e paraqitura dhe konkluzionet e miratuara në lidhje me çështjet e rendit të ditës

19.3 Procesverbali sipas rregullit I shpërndahet nëpërmes postës elektronike dhe mënyrave të tjera të gjithë asambleistëve më së voni një (1) ditë para seancës që do të mbahet.

19.4 Sekretari/ja i/e Asamblesë ka për detyrë përgatitjen dhe ruajtjen e procesverbaleve origjinale të seancave të Asamblesë

Neni 20 **Publikimi dhe njoftimi**

20.1 Puna e Asamblesë është publike, ku të gjitha procesverbalet, planet e veprimit, minutat e takimeve, publikimet dhe çfarëdo e dalur nga asambltë, publikohen në ëeb faqen e Asamblesë (<http://akf-rks.org>) dhe mbikqyret nga Sektori për të Drejtat e Njeriut.

20.2 Kryesia kujdeset për informimin e rregullt të anëtarëve dhe publikut për punën dhe aktivitetet e Asamblesë, qoftë drejtëpërdrejtë, komisionit për informim ose përmes publikimit të aktiviteteve

Neni 21 **Bashkëpunimi**

21.1 Për të arritur qëllimet, Asambleja krijon kontakte dhe bashkëpunon me shoqatat dhe organizatat e tjera profesionale, shkencore, arsimore dhe të ngjashme

21.2 Asambleja bashkëpunon me Komunën dhe Kuvendin e Komunës

Neni 22 **Mjetet dhe financimi**

22.1 Mjetet e nevojshme për funksionimin dhe financimin e aktiviteteve realizohen përmes planifikimit buxhetor komunal dhe qeveritar (buxheti miqësor për fëmijët), mbledhjes së fondeve në shkolla, kontributet vullnetare të nxënësve, mësuesve, prindërve dhe donacionet nga organizatat e biznesit si dhe donator tjerë.

Neni 23
Modifikimi i Rregullores

23.1 Ndryshimet në Rregullore janë të mundshme në bazë të një të tretës (1/3) së anëtarëve të Asamblesë

Neni 24
Pushimi i punës së Asamblesë

24.1 Asambleja pushon së punuari me vendimin e shumicës së anëtarëve, kur pushojnë kushtet për arritjen e objektivave

Neni 25
Dispozitat përfundimtare

25.1 Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset Sektori për të Drejtat e Njeriut, Drejtoria Komunale e Arsimit si dhe Drejtoritë tjera Komunale.

Neni 26
Hyrja në fuqi

26.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas rexhistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Viti, Prill 2019

Kryetari i Komunës
Sokol HALITI





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2018, për Transparencën në Komuna, neni 7 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, neni 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen në diskutim publik për propozimin rregullor për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunale Miqësorë për fëmijë

Neni 1

Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të shpallë në diskutim publik propozim rregullor për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunale Miqësorë për fëmijë.

Neni 2

Propozimi në diskutim publik i propozim rregullor për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunale Miqësorë për fëmijë do të jepet në diskutim publik deri me: 30.05.2019.

Neni 3

Debat i publik do të mbahet me datën: 03.06.2019 në ora 11:30 në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive për propozimet rregullore për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunale Miqësorë për fëmijë

Neni 6

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues:

Kryetari i Komunës, Sokol Haliti





Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë

Opstina Vitina

Municipality of Vitina

**PROPOZIM RREGULLORE PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË
FËMIJËVE PËRMES SISTEMIT QEVERISËS KOMUNAL MIQËSOR
PËR FËMIJËT**

Viti, Prill 2019

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1, pika h të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenit 50 paragrafi 1 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM RREGULLORE

PËR

REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE PËRMES SISTEMIT QEVERISËS KOMUNAL MIQËSOR PËR FËMIJËT

(PËR NJË KOMUNË MIKE PËR FËMIJËT)

DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

Qëllimet dhe fushëveprimi

1. Kjo Rregullore përcakton masat për realizimin e të drejtave të fëmijëve (vajzave dhe djemve) në sistemin qeverisës komunal dhe kontribuon në krijimin e një komune mike për fëmijët.
2. Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për të gjithë fëmijët më të përjashtuar dhe më të cenuar (pavarësisht races, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik apo ndonjë mendimi tjetër, përkatësisë etnike, pasurisë, aftësisë së kufizuar, prejardhjes familjare të fëmijëve, prindërve të tyre apo kujdestarëve ligjor) dhe shtrihet në të gjitha institucionet të cilat janë nën administrimin e Komunës së Vitisë, apo veprojnë në nivel komunal, përderisa pavarësia e tyre nuk cenohet në përputhje me ligjin.
3. Kjo Rregullore është kontribut për të siguruar se Komuna e Vitisë hap pas hapi po ndërton një shoqëri të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.

Neni 2

Përkufizimi i fëmijës

1. Fëmijë konsiderohet secili person nën moshën 18 vjeçare.
2. Fëmijët deri në moshën 18 vjeçare i gëzojnë të gjitha të drejtat e njeriut siç parashihet në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës e miratuar nga Asambleja e Përgjithëshme e Kombeve të Bashkuara dhe në Konventat dhe Standardet tjera të zbatueshme që sigurojnë realizimin progresiv të të drejtave të tyre.
3. Fëmijët janë kategori e veçantë e personave të cilët për shkak të moshës, zhvillimit fizik, intelektual dhe psikurisë duhet t'i realizojnë të drejtat e tyre me mbështetjen e të rriturve. Prindërit, familjet, kujdestarët dhe institucionet e qeverisjes lokale mbajnë përgjegjësi për

realizimin e të drejtave të fëmijëve për të siguruar ruajtje dhe kujdes të veçantë, përfshirë mbrojtjen e duhur ligjore para dhe pas lindjes së tyre.

Neni 3

Parimet e përgjithëshme për të drejtat e fëmijëve

1. Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm Konventa) i obligon shtetet që t'i sigurojnë të drejtat e fëmijës në mënyrë të plotë siç janë përcaktuar në konventë.

2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, legjislacioni dhe aktet nënligjore udhëhiqen nga parimet e Konventës.

2.1. **Mos diskriminimi** - nënkupton se të gjithë fëmijët brenda legjislacionit në fuqi, i gëzojnë të drejtat e barabarta pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, përkatësisë etnike, sociale, statusit ekonomik të fëmijës, prindërve apo kujdestarit ligjor.

2.2 **Interesat më të mira të fëmijës** – nënkupton se në rast të ndonjë vendimi nga ana e institucioneve, së pari do të merret parasysh interesi më i mirë i fëmijës, i cili është subjekt i vendimit.

2.3 **E drejta e jetesës, mbijetesës dhe zhvillimit** – nënkupton sigurimin e një jete sa më cilësore për fëmijët, jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në atë mendor, emocional, social dhe kulturor.

2.4 **Pikëpamjet e fëmijës** – nënkupton lirinë e fëmijëve për t'i shprehur pikëpamjet e tyre mbi çështjet që lidhen me ta si dhe obligimin e institucioneve për t'i marrë parasysh ato kur të marrin vendime që ndikojnë tek këta fëmijë, gjithmonë në përputhje me nivelin e zhvillimit të fëmijës.

Neni 4

Komuna mike për fëmijët

1. Komuna mike për fëmijët është një system i qeverisjes së mirë lokale, e angazhuar për zbatimin e plotë të Konventës dhe transformimin e Konventës në praktikë të përditshme.

2. Komuna mike për fëmijët i garanton secilit fëmijë që do të:

2.1 Ndikojë apo marrë pjesë në vendimet e Komunës

2.2 Shprehë pikëpamjet për Komunën

2.3 Marrë pjesë në jetën familjare të komunitetit dhe në jetën sociale

2.4 Marrë shërbimet kryesore si kujdesi shëndetësor, arsimimi dhe kujdesi alternative

2.5 Të jetë i mbrojtur nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi apo çfarëdo rreziku tjetër cenues për shkak të moshës apo gjinisë

2.6 Ecë i sigurt në rrugët e qytetit

- 2.7 Takohet dhe luaj me shokët
- 2.8 Të ketë hapësira të gjelbëruara
- 2.9 Të jetojë në një mjedis të pastër
- 2.10 Të marrë pjesë në ngjarjet kulturore, sportive dhe rekreative
- 2.11 Të jetë një qytetarë i barabartë i komunës, me qasje në secilin shërbim pa diskriminim

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 5

Përgjegjësitë për të drejtat e fëmijës

1. Realizimi i të drejtave të fëmijës është përgjegjësi kryesore e familjes dhe institucioneve qendrore e lokale
2. Institucionet komunale dhe zyrtarët që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve si dhe çdo subjekt tjetër që lidhet me fëmijët, kanë përgjegjësi sociale dhe ligjore për t'u angazhuar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës në përputhje me konceptin e komunës mike për fëmijë.
3. Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës në komunë, përfshinë (por nuk kufizohet), këto palë:
 - 3.1 Kryetari I Komunës, Kuvendi Komunal dhe drejtoritë komunale
 - 3.2 Ministritë e linjës me kompetenca të deleguara
 - 3.2 Institucionet e drejtësisë (Policia, Prokuroria, Gjykata, Shërbimi Sprovues I Kosovës, Shërbimi Korrektues I Kosovës, etj)
 - 3.3 Sektori për të Drejtat e Njeriut në Komunë
 - 3.4 Qendra për Punë Sociale
 - 3.5 tryeza multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve
 - 3.6 Institucionet shëndetësore
 - 3.8 Institucionet publike dhe private të arsimit parauniversita
 - 3.9 Klubet, shoqatat sportive dhe artistike
 - 3.10 Institucioni I Avokatit të Popullit
 - 3.11 Këshillat e fshatrave dhe lagjet urbane
 - 3.12 Shoqatat e prindërve

3.13 Organizatat e shoqërisë civile

3.14 Zyrat dhe njësitë e organizatave ndërkombëtare në komunë

3.15 Organet tjera (formale dhe joformale) që si qëllim parësor kanë promovimin dhe mbrojtjes së përgjithëshme sociale dhe mirëqenies së të gjithë fëmijëve.

Neni 6

Mekanizmat koordinues për të drejtat e fëmijës

1. Mekanizmi koordinues komunal, shërben si një platformë apo rrugë për vendosjen e prioriteteve dhe sistemeve të sigurimit të cilësisë për formësimin e çështjeve dhe zgjidhjeve për fëmijë, veçanërisht për vënien në praktikë të angazhimeve dhe veprimeve të politikave ekzistuese.

2. Mekanizmi koordinues komunal krijon një mjedis mundësues për përgatitjen e planeve të veta për zhvillim

3. Kryetari i Komunës me themelon mekanizmin koordinues komunal për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve.

4. Mekanizmi koordinues përbëhet nga përfaqësuesit e institucioneve të përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregullore

5. Mekanizmi koordinues udhëhiqet nga Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

5.1 Mekanizmi koordinues do të:

1.1 Promovoj konceptin e komunës mike për fëmijë dhe praktikat e përkufizuara sipas mjeteve dhe udhëzimeve të krijuara

1.2 Sigurojë koordinimin e politikave të cilat ndikojnë tek fëmijët

1.3 Sigurojë që aktet nënligjore të nivelit loka të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve

1.4 Kryen vëtvlerësime periodike, të cilat me veprime dhe politika që duhet të ndërmerren nga institucionet komunale në mënyrë që të krijohet një komunë mike për fëmijë

1.5 Udhëheqë procesin e hartimit të strategjisë komunale dhe planit të veprimit për fëmijë në baza periodike dhe të përcjellë zbatimin e tij bazuar në vëtvlerësim komunal

1.6 Strategjia komunale dhe plani i veprimit për të drejtat e fëmijëve miratohen në Kuvendin e komunës

1.7 Sigurojë një system komunikimi që mundëson rrjedhën dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve komunale dhe njërive specifike të institucioneve relevante, përgjegjëse për çështjet e fëmijëve

1.8 Bënë rekomandime për të vepruar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve

7. Mekanizmi koordinues nuk e përjashton krijimin e organeve, ekipeve dhe trupave të tjerë, në varësi të këtij mekanizmi, qofshin ato të përkohëshme apo të përhershme, të orientuara në aspekte të veçanta të të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, kjo e fundit duhet t'i mbajë marrëdhëniet me organet e krijuara, të raportojë mbi punën e tyre dhe të marrë këshilla dhe rekomandime nga mekanizmi koordinues.

Neni 7

Tryeza Multidisiplinare për Ndhimë në Menaxhimin e Rastit

1. Tryeza multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve, themelohet në Komunën e Vitisë në nivelin profesionistësh sipas legjislacionit në fuqi
2. Tryeza multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve, udhëhiqet nga menaxheri i rastit, në koordinim dhe bashkëpunim me strukturat dhe shërbimet përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës

Neni 8

Vlerësimi i ndikimit të fëmijës

1. Komuna zhvillon një proces për vlerësimin e ndikimit të politikave, legjislacionit, strategjive e planeve të veprimit dhe programeve për fëmijë
2. Ky proces vlerëson situatën e të gjithë fëmijëve me vëmendje të veçantë tek fëmijët nga grupet e cenuara
3. Sigurohet që vlerësimi i ndikimit tek fëmijët fillon mjaft herët gjatë analizës së situatës dhe formulimit të ndërhyrjeve për të pasur ndikim në vendim-marrje
4. Kryen një vlerësim të rregullt të ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale tek fëmijët
5. Sigurohet një hapësirë për procesin e pavarur të vlerësimit në lidhje me ndikimin e politikave në praktikë dhe shërbimet për fëmijë.

Neni 9

Sistemi i raportimit të rregullt mbi gjendjen e fëmijëve

1. Kryetari i Komunës i raporton Kuvendit të Komunës për punën dhe funksionimin e mekanizmit koordinues mbi të drejtat e fëmijëve
2. Mekanizmi koordinues i përcakton treguesit dhe të dhënat që janë prioritete të komunës për fëmijët dhe intereset e tyre
3. Komuna i përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve komunale në mbledhjen e të dhënave dhe raportimin nga sektorët përkatës të lidhura me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Në rast kur komuna nuk ka të dhëna të mjaftueshme, ata janë të obliguar t'i sigurojnë ato në bashkëpunim me nivelin qendror
4. Komuna e cakton njësinë përgjegjëse në komunë, për të nxjerrë të dhëna të rëndësishme dhe raportim të rregullt mbi statusin e treguesve, të cilët sigurohen nga institucionet përgjegjëse komunale dhe uraportohet zyrtarisht në bazë vjetore

5. Komuna i shfrytëzon në mënyrë efektive raportet për të zhvilluar politika, strategji komunale, plane të veprimit dhe buxhetim për fëmijë dhe duke u bazuar në nevoja kërkon që njësitë përgjegjëse t'i azhurojnë të dhënat dhe raportimet në çdo kohë

6. Bazuar në trendet e zhvillimit komunal, mekanizmi koordinues i shqyrton treguesit dhe raporton periodikisht në mënyrë që t'i rishikojë ato bazuar në nevoja

Neni 10

Buxhetimi për fëmijë

1. Komuna zhvillon një proces për analizimin e nevojave të buxhetimit për fëmijët e komunës, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit. Ky proces përfshinë:

1.1 Identifikimin nëse fëmijët janë duke i pranuar pjesët e duhura të burimeve për investime publike, në shërbime ku shpërdarja administrohet nga niveli i vendit

1.2 Identifikimi i nevojave për shërbime sociale për fëmijët dhe mbështetja e planifikuar përmes buxhetit komunal

1.3 Analizën adekuate të buxhetit të përgjithshëm komunal dhe elementet brenda tij, në mënyrë që të përcjellët pjesa që është shpenzuar për fëmijë dhe të shfrytëzohen dëshmitë e gjeneruara për të investuar në fëmijë.

Neni 11

Promovimi i të drejtave të fëmijëve

1. Komuna ndërmerr masa të qarta në mënyrë që të promovohen dhe respektohen të drejtat e fëmijëve, si nga fëmijët ashtu edhe nga të rriturit.

2. Masat për promovimin e të drejtave të fëmijëve përfshijnë (por nuk kufizohen në):

2.1 Organizimin e trajnimeve mbi të drejtat e fëmijëve për udhëheqësit dhe zyrtarët komunal

2.2 Përfshirjen e mësimit rreth të drejtave të fëmijëve dhe Konventës për të Drejtat e fëmijëve në kurrikulen me bazë në shkollë

2.3 Përfshirjen e mësimit, promovimit dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve, në kuadër të programeve të trajnimit para dhe gjatë shërbimit për persona të cilët punojnë me ose për fëmijë në nivel komunal

3. Vlerësimin e rregullt të njohurive për të drejtat e fëmijëve në mesin e të rriturve dhe fëmijëve

4. Promovimin e punës së institucioneve, të cilat e kanë mandate ligjor promovimin, monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

5. Komuna krijon partneritete me institucionet qendrore, organizatat e shoqërisë civile, grupet e të rinjëve dhe mediat për t'i promovuar të drejtat e fëmijëve

Neni 12

Cilësia e shërbimeve për fëmijë në nevojë

1. Komuna ndërmerr masa për ofrimin e shërbimeve cilësore për fëmijët në nevojë sipas legjislacionit në fuqi
2. Komuna bashkëpunon ngushtë me organizatat e shoqërisë civile të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 13

Avokimi i pavarur për fëmijë

1. Komuna krijon një sistem të qëndrueshëm të partneritetit me organizatat e shoqërisë civile dhe institucione të pavarura, të cilat avokojnë për të drejtat e fëmijëve. Në këtë drejtim, në këtë drejtim:
 - 1.1 Organizatave të shoqërisë civile, u ipet mbështetje adekuate për të zhvilluar kapacitetet e tyre për të ndikuar në vendimmarrje në mënyrë të pavarur në fushën e të drejtave të fëmijëve
 - 1.2 Inkurajohen dhe mbështeten organizatat e të rinjëve dhe fëmijëve
 - 1.3 Lehtësohet themelimi i institucioneve të pavarura për të drejtat e fëmijëve
 - 1.4 Mbahen komunikime të rregullta me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet e pavarura në mënyrë që të sigurohet një situatë e qartë e fëmijëve në komunë nga një perspektivë tjetër
2. Kuvendi i Komunës, organizon të paktën një seancë vjetore për t'iu diskutuar çështjet e të drejtave të fëmijës, duke iu referuar raportit të situatës për fëmijë, sipas nenit 9, paragrafi 4 të kësaj rregullore
3. Komuna organizon "ditët mike për fëmijë" (të paktën 3 ditë në vit) dhe diskuton çështjet lidhur me të drejtat e fëmijës

Neni 14

Pjesëmarrja e fëmijës

1. Komuna siguron pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në rastet me interes për ta të çdo procesi vendimmarrës në nivel komune. Të gjithë syrtarët publikë, institucionet dhe njësitë komunale janë të obliguara ta pasqyrojnë këtë në punën e tyre.
2. Institucionet educative e mundësojnë mësimin dhe praktikimin e pjesëmarrjes aktive përmes kurrikulës së shkollës dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare dhe në koordinim me institucionet e sektorëve përkatës të cilët janë në kontakt të drejtëpërdrejtë me fëmijët gjatë ofrimit të shërbimeve për ta (shëndetësia, mirëqenia sociale, arsimit, etj)
3. Institucionet educative kulturore dhe sportive, nxisin krijimin dhe funksionimin e organizatave të fëmijëve dhe të rinjëve

4. Organet administrative në komunë, në rastin e vendim-marrjes për rastet që ndikojnë tek fëmijët, i marrin plotësisht parasysh pikëpamjet e fëmijëve dhe në përputhje me praktikat dhe udhëzimet e përcaktuara nga legjislacioni ekzistues dhe i përshtatshëm për moshën e tyre
5. Pjesëmarrja kuptimplotë e fëmijëve sigurohet në procesin e vlerësimit të ndikimit të ligjeve, politikave dhe praktikave tek fëmijët në procesin e raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë, në procesin e buxhetimit për fëmijë si dhe në promovimin e të drejtave të fëmijëve
6. në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e fëmijëve, komuna e merr parasysh dhe bashkëvepron rregullisht me Asamblenë Komunale të Fëmijëve, si organ primar që i përfaqëson në mënyrë të drejtëpërdrejtë opinionet dhe pozitën e të gjithë fëmijëve në veçanti të atyre më të cenuarve.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE
Neni 15
Procedurat për zbatimin e Rregullore

1. Mekanizmi koordinues e monitoron zbatimin e kësaj rregullore dhe harton raporte vjetore për nivelin e zbatimit të saj
2. Kuvendi i Komunës shqyrton dhe miraton raportin vjetor të mekanizmit koordinues për nivelin e zbatimit të rregullore dhe në rast të mos zbatimit të saj merr vendime për masat eventuale për sigurimin e zbatimit të saj të plotë
3. Në rast të mos përmbushjes së detyrave lidhur me zbatimin e Rregullore nga zyrtarë publik, organet përkatëse komunale marrin masa adekuate në pajtim me procedurat komunale.
4. Kryetari i Komunës, brenda tre (3) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore, nxjerr vendimet e parapara sipas Nenit 5, paragrafi 3 si dhe Nenit 9, paragrafi 3 për zbatimin e saj.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi, 15 ditë pas rexhistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Prill, 2019


Kryetari i Komunës

Sokol HALITI





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Nga: Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane

Për: Kuvendin Komunal të Vitisë

Lënda: Informatë (raport) mbi punën e Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe në Statutin e Komunës së Vitisë, rregulloren e Kuvendit Komunal të Vitisë për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vitisë, rregullorja nr.01-013/858 e datës 17.07.2012, ka formuar komisionin për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane me këtë përbërje: Basri Sylejmani, Avdi Rexhepi, Fatlum Demiri, Tefik Salihu. Në si komision jemi takuar, nga i cili takim kemi përgatit njoftimin për procesin e fillimit të zgjedhjes së kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Njoftimi me datën 01.02.2019 është publikuar në web faqen e Komunës së Vitisë, kryetari i komunës, me datën 01.02.2019 ka ftuar në takim të gjithë kryetaret e fshatrave të cilët i ka falënderua për punën e bërë dhe të cilëve ju kemi dhënë nga një njoftim dhe kemi kërkuar nga ata që t'i njoftojnë të gjithë qytetarët e atyre lokaliteteve. Anëtar i komisionit Fatlum Demiri, me datën 05.02.2019 ka mbajtur një intervistë me Plus Televizionin, e cila intervistë u publiku nga i njëjti televizion përmes së cilës i kemi njoftu të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë për fillimin e këtij procesi.

Aktiviteti: Zgjedhja e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane

Takimet me qytetare për zgjedhja e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, janë mbajtur sipas këtij orari:

Data e Takimi me qytetaret	Lokaliteti / Vendbanimi	Numri i pjesëmarrësve			Mënyra e votimit, Kryetari dhe anëtarët e këshillit
		M	F	Total	
19.02.2019	Viti	53	20	73	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i hapur Kryetare e zgjedhur: znj.Xhilsime Qamili, nuk ka pasur kundërkandidat. Anëtarët e këshillit të qytetit të Vitisë: Isa Hasani, Emine Salihu, Herolind Haxhiu, Kadri Aliu, Sadri Abazi, Selami Avdyli, Lirie Aliu, Otoneta Tahiri, Adifete Maliqi, Qemajl Neziri.
20.02.2019	Drobesh	59	4	63	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i mbyllur Kryetar i zgjedhur: z.Bislim Bislimi me 57 vota Anëtarët e këshillit të fsh. Drobesh Burim Berisha, Memetali Hajdini, Avni Peposhi, Armend Selmani, Fidan Jashari, Ejup Hajdini, Bekim Muja, Burim Qazimi
20.02.2019	Gërmovë	62	2	64	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i hapur Kryetare i rizgjedhur: z.Vehbi Tahiti, nuk ka pasur kundër kandidat. Anëtarët e këshillit të fsh.Germovë: Isuf Bajrami, Blerim Lamallari, Ismet Ismajli, Fevzi Mema, Haset Hasani, Bashkim Lamallari, Mejdi Selimi, Edona Sylejmani, Dardana Sylejmani, Skender Sylejmani
21.02.2019	Goshicë	52	0	52	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i hapur Kryetare i rizgjedhur: z.Muhabi Zejnullahu, nuk ka pasur kundër kandidat. Anëtarët e këshillit të fsh. Goshicë: Bujar Metallari, Jahi Maliqi Adhurim Bajrami, Avdyli Rashiti Ramush Bilalli, Sejdi Emimi, Luar Islami, Kastriot Ademi, Arif Limani Fetah Fetahu

21.02.2019	Smirë	71	1	72	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur • Kryetare i zgjedhur: z.Tajar Hyseni, nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh.Smirë: Jakup Demiri, Florent Ymeri, Nijazi Fejzullahu, Veton Ademi, Arton Elezi, Lirie Mustafa, Besnik Imeri, Granit Avdyli, Shefqet Shaqiri, Imri Sahiti.
22.02.2019	Buzovik	47	0	47	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur • Kryetare i rizgjedhur: z.Mehmetali Shefkiu, nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh. Buzovik: Shaban Rama, Emrush Baftiari, Murat Idrizi, Avdyll Rrahimi, Besart Idrizi, Sokol Mehmeti, Hajdin Bekteshi, Alban Qamili.
22.02.2019	Shushtë	25	0	25	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur dhe i mbyllur. • Kryetare i zgjedhur: z.Hamit Zeneli me 13 vota kurse kundër kandidati z.Xhevat Zeneli 12 vota. • Anëtarët e këshillit të fsh. Shushtë: Hasan Zeneli, Xhevat Zeneli, Driton Zeneli, Aziz Iseni, Hestet Mehmeti, Remzi Hyseni.
25.02.2019	Kabash	156	0	156	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i mbyllur • Kryetare i zgjedhur: z.Arben Jakupi me 106 vota kurse kundër kandidati z.Fitim Hasani 43 vota. • Anëtarët e këshillit të fsh. Kabash: Muhamet Azizi, Pal Feri, Shukri Misini, Ridvan Hasani, Shkelzen Haliti, Sokol Selmani, Dodë Simoni, Feriz Deliu, Zef, Marku, Bekim Aliu.
26.02.2019	Tërpezë	96	0	96	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i mbyllur • Kryetare i zgjedhur: z.Gazmend Salihu me 48 vota, Skender Haziri 33 vota dhe Agim Emini 15 vota. • Anëtarët e këshillit të fsh. Tërpezë: Enver Halimi, Agim Emini Vllaznim Isufi, Ukshin Ahmeti, Enis Halimi, Bekim Azizi, Flamur

					Shaqiri, Selami Rexhepi, Zahir Tahiri, Skender Haziri.
26.02.2019	Qifllak	16	2	18	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur • Kryetare u rizgjedhur: z.Ganimet Shabani, nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh. Qifllak: Vjollca Shabani, Rinor Jashari, Kadri Shabani, Herolind Shabani, Admir Shabani, Agron Shabani
27.02.2019	Radivojc	48	0	48	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur • Kryetare i zgjedhur: z. Ymer Hyseni, nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh. Radivojc: Qemajl Misini, Jeton Zeqiri, Ibrahim Devaja, Flamur Ismaili, Ramadan Pajaziti, Burim Sylejmani, Enver Januzi, Kushttrim Beqiri, Fatlum Halili, Nijazi Salihu
27.02.2019	Devajë	27	0	27	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur • Kryetare u rizgjedhur: z. Ilir Rustemi, nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh. Devajë: Veton Bajrami, Qazim Beqiri, Liridon Uka, Selver SHallti, Lulzim Misini, Leutrim Bajrami
28.02.2019	Letnicë	24	0	24	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur. • Kryetare u rizgjedhur: z.Shin Gjoni, nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh. Letnicë: Vilson Ukaj, Vaid Alija, Seudail Sinani, Gjergj Nuqi, Fadil Gashi, Krist Lenicq
04.03.2019	Beguncë	65	0	65	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur. • Kryetare i zgjedhur: z.Nexhmedin Haliti, nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh.Beguncë: Vetim Syla, Raif Musliu, Bejtush Hyseni, Urim Haziri, Selami Abazi Sami Tahiri, Avdi Bajrami, Agron Zeka, Qemajl Hyseni, Liridor Hasani.

05.03.2019	Verban	195	3	198	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. • Kryetare u rizgjedhur: z.Afrim Ramushi me 127 vota, kundër kandidati Adem Jahiri 64 vota. • Anëtarët e këshillit të fsh.Vërban: • Adem Jahiri, Bajram Sokoli, Naim Berisha, Hysni Rrahmani, Zahir Emerllahu, Isa Ramadani, Sherif Neziri, Muhamet Ukshini, Kemajl Bislimi, Naser Emini.
06.03.2019	Ballancë	40	1	41	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur • Kryetar i zgjedhur: z. Valon Latifi, nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh.Ballancë: • Bashkim Aliu, Skender Avdyli, Musli Neziri, Naser Aliu, Hyse Rama, Liridon Januzi, Hetem Kurteshi, Mubekir Veseli, Izjadin Maliqi, Burim Haliti.
06.03.2019	Zhiti	19	0	19	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur. • Kryetar i zgjedhur: z. Burim Emini, nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh.Zhiti: • Ali Pajaziti, Tajar Neziri, Kujtim Haziri, Remzi Rexhepi, Rrahim Ferati, Adnan Emini.
07.03.2019	Trestenik	39	0	39	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur. • Kryetar u rizgjedhur: z.Isuf Ibrahim, nuk ka pasur kundër kandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh.Trestenik: Xhevat Hyseni, Rejhan Ismajli, Shefki Shefkiu, Zeqir Sadriu, Izet Sherifi, Ali Xhemajli, Ahmet Ahmeti, Blerim Halili
08.03.2019	Skifteraj	90	7	97	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur. • Kryetar i rizgjedhur: z.Demush Sadiku 62 vota, Ismet Islami 14, Mustaf Abazi 8 vota, Anëtarët e këshillit të fsh. Skifteraj: Shaip Ismajli, Valmir Sahiti, Bekim Halimi, Faik Ramadani, Riad Sadiku, Selver Islami, Mustaf Abazi, Zeqir Rexhepi, Feriz Avdiu, Bekim Shabani, Nijazi Lutfiu, Eshref

					Sadiku, Ramadan Ademi, Ismet Islami
08.03.2019	Remnik	164	0	164	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. Kryetar u zgjedh: z.Besim Rexhepi 68 vota, Përparim Avdiu 67 vota, Osman Mustafa 21 vota. Anëtarët e këshillit të fsh. Remnik: Osman Mustafa, Xhevgjet Shabani, Ramadan Musliu, Riza Misini, Bajram Ibrahim, Ramadan Hasani, Ekrem Neziri, Mufail Hasani, Abedin Sejdiu, Nevzat Ibrahim, Agim Neziri, Ramush Aliu
11.03.2019	Lubishtë	60	0	60	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. Kryetar u zgjedh: z.Vebi Xhymshiti me 36 vota, Skender Mala 24 vota. Anëtarët e këshillit të fsh. Lubishtë: Selami Shema, Izet Ferizi, Ilir Metushi, Fejzë Islami, Sami Zeka, Haki Behluli, Isuf Hetemi, Pajazit Ismajli, Kadri Mehmeti.
11.03.2019	Mjak	40	3	43	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i hapur. Kryetar u rizgjedh: z.Muharrem Beqiri. Anëtarët e këshillit të fsh. Mjaku: Mala Beqiri, Xhemajl Lamallari, Fitore Beqiri, Ahmet Lamallari, Musa Ajvazi, Qlirim Metallari, Murat Lamallari, Xhezair Beqiri, Bleona Beqiri, Hajrush Mjaku.
12.03.2019	Pozharan	481	23	504	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. Kryetar u zgjedh: z. Ilir Zuka me 256 vota, Elbasan Aliu 59 vota, Qamil Rexhepi 41 vota, Tasim Halabaku 61 vote dhe 1 vote e pa vlefshme Anëtarët e këshillit të fsh. Pozharan: Elbasan Aliu, Qamil Rexhepi, Makfirete Zuka, Diturie Ramiqi, Baki Musa, Bukurije Alidema, Mentor Demiri, Rasim Terziqi, Kemajl Selimi, Majlinda Ostërgllava, Fitore Alidema, Drita

					Pira.
13.03.2019	Potgorc	15	0	15	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i hapur. Kryetar u zgjedh: z.Naim Haziri nuk pat kundërkandidat. Anëtarët e këshillit të fsh.Potgorc: Agron Haziri, Gazmend Ymeri, Zeqir Avdiu, Isuf Rexhepi, Ardian Haziri, Agush Avdiu.
13.03.2019	Ramnishtë	32	0	32	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i hapur. Kryetar u zgjedh: z. Adem Shabiu nuk pat kundër kandidat. Arbnor Ademi, Njazi Avdiu, Ilir Syla, Nasuf Abazi, Bekim Sylejmani, Hekrem Hasani, Hasan Ademi, Lauran Demiri.
14.03.2019	Ramjan	112	5	117	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. Kryetar u rizgjedh: z. Kadri Ismajli me 64 vota, Eror Hyseni 52 vota. Anëtarët e këshillit të fsh.Ramjan: Hazbi Ismajli, Ekrem Zejnullahu, Liridon Emerllahu, Ridvan Emerllahu, Rafiz Ismajli, Sadat Rexhepi, Makfir Zejnullahu, Naser Rexhepi, Hamdush Hyseni, Zeqir Hyseni
14.03.2019	Fshati i Ri	118	5	123	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. Kryetar u zgjedh: z. Bajrush Zeneli me 78 vota, Perparim Sadiku 44 vota. Anëtarët e këshillit të Fshatit te Ri: Përparim Sadiku, Arben Selmani, Qendrim Hajrizi, Veton Ramadani, Florim Brahim, Hamit Beqiri, Arben Shaqiri.
15.03.2019	Sllatinë e Epërme	450	74	524	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. Kryetar u zgjedh: z.Daut Drugzani me 233 vota, Ekrem Ymeri 208 vota, Isuf Qosa 36 vota Anëtarët e këshillit të fsh. Sllatinë e Epërme: Ekrem Ymeri, Bedri Ymeri, Dashnim Ymeri, Elbasan

					Ahmeti, Flamur Dauti, Irfan Rexhepi, Osman Lluleci, Idriz Ajvazi, Ismet Hoxha, Valzim Drugzani, Musli Qosa, Muhamet Arapi, Kushtrim Ajvazi, Bashkim Sefedini.
18.03.2019	Sadovinë e Jerlive	55	1	56	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur • Kryetar u rizgjedh: z. Sefedin Fetahu • Anëtarët e këshillit të fsh. Sadovinë e Jerlive: Dianë Avdyli, Mentor Aylejmani, Bislim Shabani, Sabri Miftari, Rinor Imeri, Elham Fazliu, Faredin Selmani, Bekim Misini.
18.03.2019	Sadovinë e Çerkezëve	79	0	79	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i mbyllur. • Kryetar u zgjedh: z.Ermal Ismajli me 64 vota, Fatmir Islami 15 vota, • Anëtarët e këshillit të fsh. Sadovinë e Çerkezëve: Agim Xheladini, Rexhep Osmani, Premtim Bilalli, Qëndrim Hasani, Xhevdet Mehmeti, Bejtullah Musliu, Xhemajl Shabani, Gazmend Ismajli.
19.03.2019	Debelde	19	0	19	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur. • Kryetar u zgjedh: z.Fazli Neziri. • Anëtarët e këshillit të fsh. Debelde: Mehmet Rrahmani, Selajdin Ismajli, Fekir Ilazi, Zymri Azemi, Sabri Syla, Halil Neziri.
19.03.2019	Goden i Madh	27	0	27	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i mbyllur • Kryetar u zgjedh: z. Bajram Azizi me 17 vota, Nexhat Shaqiri 9. • Anëtarët e këshillit të fsh.Goden i Madh: Përparim Hafizi, Ramiz Limani, Nexhat Shaqiri, Ekrem Sahiti.
20.03.2019	Sllatinë e Poshtme	19	0	19	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra e votimit: Votim i hapur. • Kryetar u zgjedh: z.Neriton Demelezi. Nuk pat kundërkandidat. • Anëtarët e këshillit të fsh.Sllatinë e Poshtme: Mafil Frangu, Ylber Sylejmani, Zenel Frangu, Halil Lubishtani, Bejtulla Demelezi, Shefki Hajrullahu, Arber Frangu.

28.03.2019	Stubëll e Poshtme	0	0	0	
28.03.2019	Stubëll e Epërme	44	3	47	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i hapur. Kryetar u rizgjedh: z. Marjan Ramaj. Nuk pat kundërkandidat. Anëtarët e këshillit të fsh.Stubëll e Epërme: Kolë Ramaj, Gjergj Munishi, Ilir Ukaj, Luljana Toma, Elizhbeta Dodes, Jozef Ramaj, Luz Zefi, Agim Demaj, Lulzim Toma, Anton Gjergji.
29.03.2019	Budrikë	21	0	21	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i hapur Kryetar u zgjedh: z.Arben Sahiti nuk pat kundërkandidat. Anëtarët e këshillit të fsh.Budrikë: Menderes Mehmeti, Muhamet Mustafa, Faton Sadiku, Ali Sadiku, Bekim Shabani, Fatmir Azizi, Ali Hasani, Zahir Jashari.
31.03.2019	Binë	42	1	43	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e votimit: Votim i hapur Kryetar u zgjedh: z. Alia Toma nuk pat kundërkandidat. Anëtarët e këshillit të fsh.Binë: Agron Ferizi, Besart Marku, Bozha Stephani, Anton Simani, Samet Ilazi, Albert Gega, Viktor Steoani, Nikolina Marku.
Totali i pjesëmarrësve		2962	155	3117	
Përqindja:		95 %	5 %	100 %	

Gjate këtij procesi janë rizgjedhur **13 kryetar**, ndërsa kryetar të zgjedhur kemi **23**. Gjithashtu kemi edhe **1** kryetare të zgjedhur në qytetin e Vitisë. Gjithsej të zgjedhur kemi **36 kryetarë**.

Gjate këtij procesin janë zgjedhur **21 anëtare femra** të këshillave të fshatrave dhe **331 anëtar të gjinisë mashkullore**, ku gjithsej janë zgjedhur **352 anëtar të këshillave të fshatrave**. Nga kjo kuptojmë, që në këshilla të fshatit janë zgjedhur 5.96 % të gjinisë femërore, përqindje e njëjtë me pjesëmarrjen e femrës në këtë proces.

Publikimi në media:

Takimet me qytetaret të gjitha këto aktivitete janë publikuar në faqen zyrtare të internetit: www.kk.rks.gov.net/viti dhe në facebook, Komuna e Vitisë, në çdo lokalitet ku janë mbajtur zgjedhjen.

Anëtarët e Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

1. Fatlum Demiri- Kryetar i Komisionit Fatlum Demiri
2. Avdi Rexhepi- Anëtar i Komisionit Avdi Rexhepi
3. Basri Sylejmani-Anëtar i Komisionit Basri Sylejmani
4. Tefik Salihu- Anëtar i Komisionit Tefik Salihu

Informata (raporti) ju dërgohet

1. Kuvendit Komunal të Vitisë,
2. Arkivit.

Viti, Prill 2019



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVOS
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITIVA

Prenant / Prenuar / Prenar			
11-04-2019			
Nr i origjevit / Orig. broj	Identifikues / Broj	Shmërimi / Niveli	Vlera / Vendosje
12-016/01-380			



Manifestimi "Flakadani i Karadakut"
edicioni XVIII

21-26 Mars 2019

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport /
Republika e Kosovës / Komuna e Vitisë





Republika e Kosovës

Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë

Municipality of Viti/Vitina

Drejtoria për Kulturë, Rinidhe Sport

Department of Culture, Youth and Sports



DATE/A:	Prill, 2019
PËR/ZA/TO:	Komiteti për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal, Viti
NGA/ZA/FROM:	Z. Milot LALA Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport
PËRMES/OD/FROM:	Zt. Naim PIRA Kryesuesi Kuvendit Komunal
C.C	Zt. Sokol HALITI Kryetari Komunës së Vitisë
LËNDA:	Informatë për Manifestimin "Flakadani i Karadaku" edicioni XVIII

Përmbajtja


I.	KËSHILLI ORGANIZATIV I MANIFESTIMIT.....	4
a)	Përbërja e Këshillit Organizativ.....	4
b)	Ndarja e detyrave të Trupës Koordinuese.....	5
II.	RAPORTI NARRATIV I AKTIVITETEVE.....	6-9
a)	Aktivite Kulturore dhe sportive.....	7-9
III.	RAPORTI FINANCIAR I MANIFESTIMIT.....	10-11
a)	Tabela e kostos totale buxhetore.....	10
b)	Tabela e shpenzimeve per sherbime	11
c)	Tabela krahasuese (2018-2019) e shpenzimeve.....	11
IV.	MBËSHTETËSIT E MANIFESTIMIT DHE MEDIAT.....	12

I. KËSHILLI ORGANIZATIV I MANIFESTIMIT

a) Përbërja e Këshillit Organizativ

1. Sokol Haliti - Kryetar i Komunës - Kryetar i Këshillit Organizativ
2. Hasan Aliu - anëtar
3. Naim pira - anëtar
4. Milot Lala - anëtar
5. Nexhmedin Jakupi - anëtar
6. Fatbardha Emini- anëtare
7. Kosovar Azemi - anëtar
8. Qahil Sinani - anëtar
9. Qemajl Rexhepi - anëtar
10. Avdyl Bajrami - anëtar
11. Agim Lipovica- anëtar
12. Ali Bajrami - anëtar
13. Mirlinda Sadiku - anëtare
14. Bekim Azizi - anëtar
15. Besim Ymeri -anëtar
16. Rasim Tërziu -anëtar
17. Ismet Sejdiu - anëtar
18. Emrush Azemi - anëtar
19. Muhabi Haxhiu - anëtar
20. Bejtush Qosa - anëtar
21. Agron Abazi - anëtar
22. Enver Osmani - anëtar
23. Adnan Zenuni- anëtar
24. Muhamet Maliqi - anëtar
25. Arianit Hetemi - anëtar

b) Ndarja e detyrave të Trupës koordinuese:



II. RAPORTI NARRATIV I AKTIVITETEVE

a) Aktivitet kulturore dhe sportive

Manifestimi Tradicional Kulturor e Sportiv “Flakadani i Kardakut 2019”, organizimi dhe mbajtja e edicionit 18-të me radhë, si një nga ngjarjet më të mëdha kulturore në Komunën e Vitisë, ku tubon artistët dhe grupet artistike e të mbarë Kombit Shqiptar e me gjere.

Ky eveniment kulturore e sporti, u mbajt në saje mbështetjes së projektit “Flakadani i Karadakut 2019”, nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë Z. Sokol Haliti, dhe punës së palodhshme të Trupës Koordinuese.

Manifestimi Tradicional Kulturor e Sportiv “Flakadani i Karadakut 2019” ka filluar më 21 mars 2019, ku u bë hapja solemne e manifestimit me dhezjen e Flakadanit dhe ka përfunduar më 26 mars me mbrëmjen finale të Festivalit Mbarëkombëtar të Ansambleve dhe Shoqërive Kulturore dhe Artistike. Në këtë tubim pos udhëheqjes komunale dhe shoqatave të ndryshme prezantuan edhe mysafir të shumtë nga Kosova, Shqipëria, Lugina e Preshevës, Maqedonia, Mali i zi dhe nga Diaspora shqiptare e cila jeton dhe vepron në Zvicër.

Aktivitetet Kulturore dhe sportive:

- **Garat regjionale të recituesve** – u mbajtën në sallën e mbledhjeve të Shtëpisë së Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, më 22 Mars 2019 me fillim në ora 11.00. Në këto gara prezantuan nxënësit e shkollave të mesme të komunave: Preshevë, Bujanoc, Kaçanik, Kamenicë Gjilan, Viti dhe Ferizaj.

Juria profesionale e përbërë nga përfaqësuesit e komunave përkatëse, vlerësuan që **vendi i parë** t'i takoi Lidiona Marovca – SHM “Ismail Qemajli nga Kamenica me poezinë ‘Do të flas’ kurse **vendi i dytë** iu nda Sajmir Maliqit - Gjimnazi “Skënderbeu” – Preshevë me poezinë “Abetaren time” ndërsa me **vendin e tretë** u shpërblye Majlinda Shehu – SHMP “ Feriz Guri dhe Vëllezrit Çaka ” nga Kaçaniku.

Për të gjitha shkollat pjesëmarrëse, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si organizatore e manifestimit , ndau falënderime.

- **Ora e Madhe Letrare** – u mbajt në sallën e mbledhjeve të Shtëpisë së kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, më 23 mars 2019 me fillim në ora 14.00. Në Orën e Madhe Letrare prezantuan shkrimtarë, poetë nga të gjitha trevat shqiptare.

Juria profesionale në përbërje 3 anëtarëve me kryetar Agim Vinca, ka vlerësuar krijimet dhe poezitë më të mira të shkrimtarëve konkurrues të Orës së Madhe Letrare- “Flakadani i Karadakut 2019”.

Me çmimin e parë u nderua Prof . Dr. Isak Shema, çmimi i dytë i takoi Odise Plakut kurse çmimi i tretë u nda për poeten Vjollca Dibra

Nga ana e organizatorit, Çmimi për Vepër Jetësore iu nda Prof. Dr. Agim Vincës, kurse për kontribut të veçantë mirënjohje iu nda poetit Hyqmet Haskos nga Shqipëria.

- **Festivali Gjithëkombëtar i Shoqërive Kulturore e Artistike** – u mbajt më 24, 25 dhe 26 Mars – prezantuan 15 -të Shoqëri Kulturore artistike nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i zi, Presheva dhe Zvicëra, kurse mysafir të mbrëmjes finale të festivalit Mbarëkombëtar të ansambleve dhe Shoqërive Kulturore dhe Artistike “Flakdani i Kardakut 2019” , ishin Solistet e mirënjohura nga estrada Shqiptare Merita Sahiti, Enkelejda Arif, Prena Beci dhe Fatojna Malsiu.

Mbrëmja e parë e festivalit, më 24 Mars:

<i>Nr.</i>	<i>Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria Kulturore</i>	<i>Vendi</i>	<i>Vlerësimi i Jurisë</i>
1.	AKV "Kemajl Azizi"	Viti	Jashtë konkurrencës
2.	SHKA "Teuta"	Zvicër	
3.	AKV "Xheladin Zeqiri"	Tetovë	
4.	A K V " Hasan Prishtina"	Vushtrri	
5.	AKV "Ibe Palikuqi"	Shkup	

Mbrëmja e dytë e festivalit, më 25 Mars:

<i>Nr.</i>	<i>Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria kulturore</i>	<i>Vendi</i>	<i>Vlerësimi i Jurisë</i>
1.	SHKA "Jonuz Ramdani"	Smirë	Jashtë konkurrencës
2.	Qendra Kulturore "Kaçaniku"	Kaçanik	
3.	SHKA "Presheva Jehon"	Preshevë	
4.	SHKA "Koha"- Dinoshë	Tuz	
5.	AKV "Dance Plus Folk"	Elbasan	

Mbrëmja e tretë e festivalit, më 26 Mars:

Nr.	Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria kulturore	Vendi	Vlerësimi i Jurisë
1.	A K V B "Dasma"	Pozheran	Jashtë konkurrencës
2.	SHKA "Shotë Galica "	Drenas	
3.	AKV "Nakem"	Bursa	
4.	SH K A "Shamikuqet"	Ferizaj	
5.	AKV "Bajram Shabani"	Kumanovë	

Juria profesionale në përbërje: Sami Piraj muzikolog, Dilaver Kryeziu koreograf dhe Minella Kureta mjeshër i Madh, vlerësuan dhe ndanë 3 vendet e para dhe çmimin special të Festivalit Gjithëkombëtar të Shoqërive dhe Ansambleve Kulturore Flakdani i Karadakut 2019"

Vendin e parë iu nda AKV "Hasan Prishtina" nga Vushtrria, vendi i dytë AKV " bajram Shabani" nga Kumanova dhe vendi i tretë i takoi AKV " Xheladin Zeqiri" – Tetovë. Ndërsa me çmimin special u nderua AKV " Nakem" nga Bursa.

- Më 26 Mars, me fillim nga ora 10.00, u bënë homazhe dhe vendosja e kurorave me lule te varrezat e dëshmoreve – Dëshmorit Nijazi Azemi – Komandant Mjekrra.

Aktivitetet sportive:

- Turniri i madh në futboll të vogël
- Garat sportive në Shah
- Garat sportive të pingpongut

Ku të gjitha ndeshjet u zhvilluan gjatë rrjedhës së manifestimit Kulturor dhe Sportiv "Flakadani i Kardakut-2019.

III. RAPORTI FINANCIAR I MANIFESTIMIT

a) Tabela e kostos buxhetore:

Tabela e shpenzimeve për shërbime:

Fondi burimor	Lloji i shpenzimit	Kostoja në €
Komuna e Vitisë/DKRS	Akomodimi	1,214.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Zërim	740.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Dreka (Shujta për grupet artistike dhe sportive)	9,770.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Rekuizita sportive	850.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Shtypja e mateiraleve grafike katalogje, cerada citillajda, rollop, postera, shtypja në bez e flamujve beza, gravura, fotografi etj.	2,170.00 €
Komuna e Vitisë /DKRS	Transmetimi idrejtpërdrejt aktiviteve te manifestimit "Flakadani I Karadakut 2019", nga Smart Media SH,P. K. (Plus TV)	1,376.00 €
Komuna e Vitisë /DKRS	Skenografia, ndriçimi profesional	1,200.00€
Totali:		17,320.00 €

Tabela krahasuese 2018 / 2019

"Flakadani i Karadakut 2018"	Flakadani i Karadakut 2019"
18,050.00 €	17,320.00 €

IV. MBËSHTETËSIT E MANIFESTIMIT

Mbështetësit: Komuna e Vitisë.

Mediat: Manifestimi Tradicional kulturor dhe sportive "Flakdani I karadakut 2019", u mbulua tërsisht nga "Plus Televizion", "Radio Televizioni i Kosoves", "TV 21", "TV T7", "TV Presheva", Zyra për Informim e Komunës së Vitisë, Radio Zëri i Pozheranit etj.

Viti, Prill 2019

Drejtori i DKRS:

/Milot Lala/